



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Proces verbal

Sot me datë 19.02.2026 ora 13:30 ishte parashikuar mbledhja e **Kryesisë së Këshillit Bashkiak** për shqyrtimin e rendit të ditës për mbledhjen e rradhës të Këshillit Bashkiak. Nga administrata e Bashkisë të pranishëm janë: Znj. Edita Shoshi, Z. Saimir Rustemi, Z. Bekim Mema.

Të pranishëm janë:

Mungon:

Z. Oltion Luli
Znj. Irena Shala
Z. Gjergj Sokoli
Z. Edmond Ndou
Znj. Valjeta Bajraktari

Znj. Violeta Përndrecaj

Kourumi i domosdoshëm për zhvillimin e mbledhjes është prezent, prandaj **Z. Luli** në cilësinë e Kryetarit vijon me citimin e rendit të ditës, që parashikohet për mbledhjen ardhshme të Këshillit Bashkiak, pjesë kjo që kryhet nga kryesia e Këshillit. Po ashtu vendoset edhe data e mbledhjes, e cila do të mbahet ditën e Premte, datë 27.02.2025 dhe për shkak të muajit të madhërueshëm të Ramazanit, ora e mbledhjes do jetë 15:00 me rend dite si më poshtë:

Miratimi i Procesverbalit të Mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak datë, 26.01.2026 sipas ligjit Nr.8480 datë, 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, neni 16 pika 2.

1. *Projektvendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Janar 2026”.*
2. *Projektvendim: “Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri”.*
3. *Projektvendim: “Për zgjedhjen e përfaqësuesve të Këshillit Bashkiak Shkodër në Këshillit e Qarkut Shkodër”.*
4. *Projektvendim: “Për në ndryshim në VKB nr.54 datë 30.09.2024 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nënpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë”.*

5. *Projektvendim: “Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Shkodër për vitet 2027-2029”.*
6. *Projektvendim: “Për miratimin e shtesës së planit në buxhetin e Bashkisë Shkodër, të miratuar me VKB nr. 84, datë 18.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor 2026-2028”, si dhe për përcaktimin e destinacionit të përdorimit të fondeve të akorduara të grantit të bazuar në performancë për vitin 2025.*
7. *Projektvendim: “Për miratim shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar me VKB nr. 84 datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër”, projekti ‘Shtëpia që ndërton të ardhmen – Rikonstruktion i Shtëpisë së Fëmijës (6-15 vjeç).*
8. *Projektvendim: “Për miratimin e Udhëzuesit të Aplikimit “Për zbatimin e skemës së granteve për biznese inovative, 2026 – 2028”.*
9. *Projektvendim: “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKB nr.1, datë 22.01.2016 “Për taksat e tarifat vendore në Bashkinë Shkodër”, të ndryshuar.*
10. *Projektvendim: “ Për një ndryshim në VKB nr.18 datë 20.07.2023 “Për dhënie pëlqimi për dhënie me qira të ekonomisë pyjore “Pruemos Sheldi”, Nësia administrative Gur i Zi, fshati Sheldi, ngastra 104, për aktivitetin instalim të shtyllës erëmatëse për studimin e erës, aerogjeneratorë, për një periudhë 12 muaj për shoqërinë “Volitalia Albanie” i ndryshuar.*
11. *Projektvendim: “Për miratimin e planit lokal të veprimit për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike 2026-2036”.*
12. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Diskutohet gjithashtu lidhur me projektvendimet për “Planet Sociale”. Znj.Shoshi shprehet se planet, të cilat kanë kaluar konsultimin publik, i janë përcjellë grupit të punës dhe ekspertëve të jashtëm, për të pasqyruar sugjerimet dhe ndryshimet e propozuara, prandaj nuk shihet e arsyeshme të kalojnë për miratim në këtë mbledhje, pasi nuk ka akoma gati një variant final të tyrin.

Znj.Bajraktari dhe Znj.Shala diskutojnë dhe kërkojnë të dijnë më tepër lidhur me gjokat e Policisë Bashkiak të parashikuara në projektvendimin: “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKB nr.1, datë 22.01.2016 “Për taksat e tarifat vendore në Bashkinë Shkodër”, të ndryshuar.

Z.Luli, shprehet se ky projektvendim sipas ligjit kërkon konsultim publik, prandaj të gjitha propozimet dhe sugjerimet e mundshme do të pasqyrohen në këtë projektvendim.

Z.Rustemi, drejtor i Policisë Bashkiake sqaron se përsa i përket gjobave të Policisë bashkiake nuk do ketë rritje apo ndryshime, por thjesht duhet të pasqyrohen në paketën fiskale ato që kanë qënë.

Ai shton se thjesht duhet të saktësohet terminologjia e përdorur në projektaktin e propozuar për të mos lënë vend për keqkuptime.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka, mbledhja e Kryesisë deklarohet e mbyllur.

SEKRETARE

Zbardhi procesverbalin:

Sabina Danaj

Irma Sulishti

